



## **PARAQITJE NË KOMISIONIN E EKONOMISË, FINANCAVE DHE TË PRIVATIZIMIT, 20 DHJETOR 2001.**

Të nderuar deputetë,

Banka e Shqipërisë, në zbatim të detyrimeve për transparencën dhe llogaridhënien, tashmë e ka bërë traditë raportimin në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë në lidhje me ecurinë e ekonomisë së vendit dhe në veçanti me realizimin e objektivave dhe të detyrave ligjore të bankës qendrore.

### **1. ZHVILLIMET NË EKONOMI**

Zhvillimet në ekonominë e vendit për vitin 2001, duke iu referuar të dhënave të disponueshme, vlerësohen në përgjithësi pozitive dhe brenda kuadrit të programuar. Në vitin 2001, ekonomia shqiptare vazhdoi të rritet me ritëm relativisht të shpejtë, në kushtet e mbajtjes së niveleve të ulëta të çmimeve të konsumit dhe të rënies së nivelit të papunësisë. Nga ana tjetër, zhvillimet fiskale dhe ato monetare rezultuan brenda objektivave sasiorë të përcaktuar. Monedha e vendit ka qenë relativisht e qëndrueshme si kundrejt dollarit amerikan ashtu edhe kundrejt euros. Sistemi bankar shqiptar zgjeroni më tej aktivitetin e tij, rriti nivelin e kreditimit, u bënë disa hapa përpara në drejtim të privatizimit të Bankës së Kursimeve, megjithatë nuk u arrit dot të realizohej përzgjedhja e investitorit gjë që e ka shtyrë këtë proces për të paktën dhe një vit tjetër.

Në vitin 2001, ka patur dhe vazhdon të ketë zhvillime, ndikimi i të cilave krijon vështirësi në arritjen e objektivave dhe madje efekti i tyre mund të shtrihet në periudhë afatmesme. Bëhet fjalë për problemet e shumta në furnizimin me energji elektrike e rritjen e çmimit të saj, konflikti në rajon, sidomos kriza e Maqedonisë si dhe problemet në ekonominë botërore të theksuara më tepër pas sulmit të 11 shtatorit 2001. Ashtu siç edhe është paralajmëruar kohë më parë nga ana e Bankës së Shqipërisë, problemet në furnizimin me energjinë elektrike po marrin, nga pikëpamja ekonomike, përmasat e një krize. Për më tepër, efektet negative të situatave të tilla, ndonëse mund të mos dallohen në periudha afatshkurtra, në periudha afatgjata bëhen më të prekshme.

### 1.1. Ekonomia e brendshme.

Ekonomia shqiptare në vitin 2001 pritet të rritet me 7.3 për qind në terma realë. Ky zhvillim i atribuohet kryesisht ecurisë së sektorit privat të ekonomisë, i cili po njeh gjallërim të vazhdueshëm.

Por, faktorët negativë që përmendëm më sipër e kanë vështirësuar disi këtë objektiv dhe për më tepër kanë vështirësuar ruajtjen e ritmit të rritjes për periudhën afatmesme.

Në përgjithësi, në ndryshim nga vitet e fundit, pritet që rritja e **prodhimit bujqësor** të jetë rreth 1 pikë përqindjeje më pak se sa parashikimi në fillim të vitit.

Kjo ka ardhur kryesisht si pasojë e reduktimit në rritjen e prodhimit në bujqësi ndërkohë që, prodhimi i agroindustrisë dhe i peshkimit ka ruajtur nivele të kënaqshme rritjeje.

**Tabela 1: Parashikimi i prodhimit bujqësor i vlerësuar për vitin 2001 (në milionë lekë).**

Emërtimi	Viti 2000	Parashikimi 2001	Në %
1. Bujqësia	192 977	199 127	103.2
2. Agroindustria	17 946	19 200	107.0
3. Peshkimi	1 668	1 750	104.9
Totali	212 591	220 277	103.6

Burimi: Zyra përfaqësuese e FMN në Tiranë.

Të dhënat për **prodhimin industrial në sektorin shtetëror** gjatë vitit 2001, flasin për një ecuri me lëkundje, por që në fund të fundit, përvijon tendencën rënëse të këtij sektori.

**Tabela 2: Indeksi i prodhimit industrial.**

(në % kundrejt vitit 1993)	2000		2001	
	T 4	T 1	T 2	T 3
Prodhimi industrial në volum	54.3	33.7	43.9	34.1
- Industria nxjerrëse	28.6	28.8	29.1	27.3
- Industria përpunuese	53.2	16.9	33.6	24.6
- Prodhimi i energjisë elektrike	106.3	117.8	116.5	88.9

Burimi: INSTAT, "Konjuktura", tremujori i tretë, 2001.

Siç vërehet, rëniet më të theksuara, i ka manifestuar tremujori i parë dhe i tretë, ndërsa tremujori i dytë, është karakterizuar nga rritje të aktivitetit industrial, edhe për shkak të bumit të madh që morën investimet në këtë periudhë të vitit.



Treguesi i **prodhimit mall të shitur**, flet për rënie të tij nga njëri tremujor në tjetrin. Kështu, tremujori i tretë shënoi një rënie me rreth 16.4 për qind në krahasim me një tremujor më parë. Po kështu, si dhjetëmujor, pësoi një rënie me rreth 14.3 për qind në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2000.

Të dhënat indirekte të disponueshme për **sektorin privat të ekonomisë**, dëshmojnë se, megjithë lëkundjet e herëpashershme, ky sektor vazhdon të ndjekë rrugën e gjallërimit. Gjatë vitit 2001, prirjet më të theksuara të rritjes së aktivitetit në këtë sektor evidentohen në tremujorin e dytë të tij, tremujor në të cilin edhe investimet kanë qenë më të spikatura. **Konsumi i çimentos** ka pësuar një rënie të theksuar në tremujorin e tretë në krahasim me atë paraardhës, kjo edhe për faktin tjetër se rëniet në aktivitetin ekonomik shfaqen më shumë në periudhën e stinës së pushimeve korrik – gusht. Në vijim, muaji shtator ka filluar të gjallërohet, pothuaj në të gjithë treguesit indirektë. **Konsumi i dukshëm i energjisë elektrike** ka ardhur në rënie, duke dëshmuar edhe një herë për një situatë në vështirësi dhe mjaft të brishtë të kësaj dege të ekonomisë.

Tabela 3: Ecuria e sektorit privat të ekonomisë, viti 2001.

Treguesit indirektë	Njësia e matjes në:	2001		
		T1	T 2	T 3
<b>Investimet</b>				
Importi i makinerive dhe pajisjeve	mld lekë	8.7	11.7	11.0
Konsumi i dukshëm i çimentos	mijë tone	267	506.4	301
<b>Kërkesa e brendshme</b>				
Konsumi i energjisë elektrike	mIn kwh	502	502	468
Konsumi i karburanteve	mijë tonë	73.8	73.8	92.0
Importe pajisjesh elektroshtëpiake	mijë	10.8	16.5	13.4
Importe autoveturash	mijë	7.6	3.4	3.9
<b>Tregtia e jashtme</b>				
Totali i eksporteve	mld lekë	11.3	13.0	8.5
Totali i importeve	mld lekë	41.2	47.9	46.0
Eksport/Import	%	27.4	27.2	18.4

Burimi: INSTAT.

**Dega e ndërtimit.** Megjithë të dhënat e pakta për këtë degë të rëndësishme të ekonomisë, gjykohet se ndërtimi nuk ka ecur me të njëjtat ritme zhvillimi si në vitet e kaluara. Ky sektor ka filluar të shfaqë, që në fund të tremujorit të parë të vitit dhe në vijim, rënie të ritmeve të rritjes. Fakti që edhe konsumi i çimentos ka rënë përgjatë tremujorit të tretë në krahasim me të dytin e këtij viti me rreth 40.5 për qind, dëshmon për një frenim të hapave në ecurinë e këtij sektori. Megjithëse tremujorët e dytë dhe të tretë të viteve, janë periudha gjatë të cilave aktiviteti ndërtimor kryhet më me intensitet, kjo nuk dëshmohet nga të dhënat e disponueshme. Nga ana tjetër, kufizimi i dhënies së licencave të ndërtimit nëpërmjet forcimit të kërkesave për dhënien e tyre, ka bërë që ky aktivitet të mos njohë zhvillimin e viteve të mëparshëm.

**Dega e transportit.** Ka paraqitur arritje të kënaqshme për treguesit e investimeve. Tremujorët e dytë dhe të tretë janë karakterizuar nga nivele të larta realizimesh, në krahasim me parashikimet për to.

**Tabela 4: Ecuria e realizimit të investimeve për vitin 2001.**

Investimet	Realizimet kundrejt programit (në %)		
	T 1	T 2	T 3
Gjithsej	78.6	114.6	111.96
1. Buxhetore	42.6	112.5	74.37
2. Ndihma e kredi	101	116	146.38

Burimi: Ministria e Transporteve.

Struktura e investimeve në degën e transportit, gjatë gjithë vitit 2001, ka qenë dukshëm në favor të transportit rrugor. Kështu, vetëm në gjashtëmujorin e parë të vitit 2001, në infrastrukturën rrugore u investuan rreth 90.4 për qind të totalit të investimeve të kryera në këtë degë. Kjo strukturë, vazhdon të ruhet në favor të transportit rrugor edhe gjatë tremujorit të tretë me afro 77 për qind, ndonëse në nivele më të ulëta se në pjesën e parë të vitit. Kjo, për faktin se në tremujorin e dytë të vitit 2001, pati një përqëndrim shumë më të lartë të investimeve në infrastrukturën rrugore, më të lartë se çdo vit tjetër.

## 1.2. Tregtia e jashtme.

Tregtia e jashtme, gjatë nëntëmujorit të vitit 2001 në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ka pësuar rritje në të dyja krahet e saj pra si në importe ashtu edhe në eksporte. Importet totale për këtë periudhë kapën shifrën 928 milionë dollarë amerikanë ndërsa eksportet 225 milionë dollarë amerikanë. Këto shifra janë përkatësisht 30 dhe 16 për qind më të larta se ato për të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Tremujori i dytë i vitit ka qenë tremujori me aktivitet më të lartë tregtar si për importet ashtu edhe për eksportet.




Në krahun e importeve peshën më të madhe vazhdojnë ta mbajnë grupmallrat makineri dhe pajisje (19 për qind të totalit), produkte minerale (13 për qind të totalit) dhe tekstilet dhe artikujt tekstile (9.5 për qind të totalit).

Në krahun e eksporteve pesha mbahet ekskluzivisht nga grupmallrat tekstilë dhe artikujt tekstilë dhe veshje të kokës dhe këmbës. Gjatë tremujorit të tretë tregtia e jashtme u karakterizua nga një mpirje e dukshme e eksporteve, e cila mund të shpjegohet me periudhën e pushimeve në vendet që importojnë këto mallra nga Shqipëria. Pikat më të ulëta të eksporteve shqiptare u arritën në muajt korrik dhe gusht (përkatësisht 18 dhe 14.8 milionë dollarë amerikanë) ndërsa muaji shtator shfaqti një rritje të konsiderueshme si në krahasim me muajt paraardhës ashtu edhe me shtatorin e vitit të kaluar. Siç mund të kuptohet nga të dhënat e mësipërme, eksportet vazhdojnë të mbizotërohen nga riekportet e mallrave të përpunimit aktiv. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për vendet partnere, të cilat ashtu si në të kaluarën, vazhdojnë të identifikohen me Italinë dhe Greqinë.

Megjithë rritjen e eksporteve në muajin shtator, deficitin tregtar krahasuar me atë të gushtit të vitit 2001 dhe të shtatorit të vitit të kaluar, pësoi një rritje të mëtejshme, përkatësisht 22.6 dhe 36.6 për qind. Ky zhvillim është domethënës dhe ai nxjerr edhe një herë në pah faktin se niveli i eksporteve është shumë i ulët dhe çfarëdo rritje relative e tyre nuk është e aftë të absorbojë rritjet relative më modeste që ndodhin në krahun e importeve.

Ekonomia e brendshme dhe sektori i jashtëm i saj janë zhvilluar nën një klimë normale të ecurisë së **kursit të këmbimit** gjatë vitit 2001. Deri në mesin e muajit nëntor të vitit 2001, zhvillimet e kursit të këmbimit kanë shfaqur një ecuri të qëndrueshme duke ndjekur trendin normal të zhvillimit.

Kështu, në tregun shqiptar u konfirmua sjellja simetrike e kundërt e lekut kundrejt dy monedhave kryesore, dollarit amerikan dhe euros. Gjithashtu, në ecurinë e kursit të këmbimit, deri në fund të muajit shtator, vihen re dhe lëkundjet normale sezonale të periudhës së verës si rezultat i fluksit të të ardhurve nga jashtë vendit.



**Grafiku 1.**

Duke filluar nga mesi i muajit shtator, pas ngjarjeve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, leku filloi të ketë lëkundje jonormale në lidhje me dollarin. Në atë periudhë pati një mbivlerësim të lekut në lidhje me dollarin, periudhë që nuk zgjati shumë dhe u pasua nga një periudhë gati njëmuajore stabiliteti ditor të lekut kundrejt dy monedhave kryesore (rreth vlerave 141-142) deri nga mesi i muajit nëntor.

Nga mesi i muajit nëntor u vu re një mbivlerësim i dukshëm i lekut si ndaj monedhës amerikane, ashtu dhe ndaj asaj europiane. Ky fenomen nuk është normal me ecurinë simetrike të deriatëhershme të kursit të këmbimit. Pas një stabilizimi të përkohshëm në fund të nëntorit, ai u shfaq përsëri në fillim të muajit dhjetor. Arsyet e këtij fenomeni mund të jenë të ndryshme. Afrimi i kohës kur do të qarkullojë fizikisht euro, të bën të mendosh se leku shqiptar po përfiton në maksimum. Një pjesë e monedhave që ka popullsia nëpër duar është këmbyer me lekun. Zgjedhja e lekut mendohet se ka ardhur si rezultat i rritjes së diferencës midis interesave në valutë dhe atyre në lekë. Kjo e ka bërë lekun shumë më tërheqës se dollarin. Pritet që ky fenomen të mbizotërojë tregun e këmbimit edhe për muajin dhjetor, edhe për arsyen e ndikimit të faktorëve sezonalë. Kërkesa për lekë rritet akoma me hyrjen e monedhave të huaja nga të ardhurit që kthehen me rastin e festave. Kjo çon në një mbiçmim të përkohshëm të lekut.

### 1.3. Tregu i punës.

**Punësimi**, megjithëse matet në praninë e një ekonomie joformale të vlerësuar si mjaft të përhapur në vendin tonë, ka shfaqur përmirësime të vazhdueshme edhe gjatë vitit 2001. Numri i të papunëve vazhdon të bjerë dhe argumenti kryesor për këtë fenomen mbetet: forcimi i sektorit



privat të ekonomisë duke siguruar hapje të vendeve të reja të punës. Norma e papunësisë në fund të muajit shtator arriti në 14.8 për qind.

**Tabela 5: Treguesit e punësimit, viti 2001.**

Treguesit	T 1	T 2	T 3
Forca e punës (në mijë)	1283	1269	1261
Të punësuar gjithsej (në mijë):	1078	1077	1074
- Sektori shtetëror			
- Sektori privat jobujqësor	198	197	194
- Sektori privat bujqësor			
Të papunë (në mijë)	119	119	119
Norma e papunësisë	761	761	761
	205	192	187
	15.96	15.1	14.80

Burimi: INSTAT, "Konjuktura", tremujori i tretë, 2001.

Nga ana tjetër, pothuajse paralelisht me numrin e të papunëve, ka rënë edhe numri i të punësuarve, fakt që nuk gjen argumentim të drejtpërdrejtë ekonomik.

Siç dihet tremujori i tretë i vitit, është karakterizuar nga një nismë e qeverisë dhe e pushteteve lokale, për prishjen e ndërtimeve pa leje, fakt që në njëfarë mënyre ka nxjerrë si të papunë një pjesë të madhe të "të ish – punësuarve". Po kështu, në këtë tremujor, një pjesë e madhe e studentëve që mbarojnë studimet e larta, gjenden si kërkues të punës në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Përballë këtyre dy fakteve të pamohueshme, numri i të papunëve njihet rënie të vazhdueshme. Ky paradoks i zhvillimeve në tregun e punës, vazhdon të jetë i ushqyer edhe nga paradoksi tjetër që prej mëse disa vitesh është vënë në dukje: ai i numrit konstant të të papunëve në sektorin privat bujqësor.

Nga rezultatet paraprake të regjistrimit të popullsisë të vitit 2001, ka rezultuar se popullsia në zonat rurale që prej vitit 1989 ka rënë me rreth 257.6 mijë banorë apo me afro 12.6 për qind, ndërkohë që të qenurit konstant i kësaj shifre nuk shpjegohet as me lëvizjet migratore të popullsisë, të cilat kanë qenë mjaft intensive gjatë dekadës së fundit, dhe të drejtuara nga fshati në qytet.

#### 1.4. Zhvillimet fiskale.

Gjatë vitit 2001, ekonomia shqiptare ka ecur në një klimë të kënaqshme të arritjes në treguesit fiskalë, falë përpjekjeve të qeverisë për vjeljen e

të ardhurave dhe për kryerjen e shpenzimeve brenda kufijve të programuar.

E veçanta e këtij viti është se u përmirësua ritmika dhe struktura e kryerjes së shpenzimeve. Nëse për vite me rradhë shpenzimet përqendroheshin në muajin dhjetor dhe shpenzimet kapitale nuk realizoheshin, këtë vit janë kryer shpenzime të konsiderueshme qysh në gjashtëmuajorin e parë të vitit dhe shpenzimet me karakter investues, gjithashtu, ishin të konsiderueshme. Investimet, kryesisht në infrastrukturën rrugore jo vetëm që patën një karakter prodhues dhe hapën vende të reja pune, por janë në shërbim të të gjithë të ardhmes së ekonomisë së vendit.

Tabela 6 : Ritmika e të ardhurave dhe shpenzimeve mujore për vitin 2001.

Miliardë lekë	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qersh.	Korrik	Gusht	Shtat.	Tetor
Totali i të ardhurave	7.1	10.9	12.0	13.1	11.0	11.7	11.5	10.6	11.1	11.6
Totali i shpenzimeve	10.8	11.2	13.8	13.2	15.5	19.7	15.9	13.4	14.3	11.5


Burimi: Ministria e Financave.

Zhvillimet e politikës fiskale, në përgjithësi, kanë rezultuar brenda kufijve të planifikuar duke mos ushtruar presione të forta mbi sistemin bankar për likuiditet. Deri në fund të muajit tetor, si dhjetëmuajor, të ardhurat janë realizuar në masën 97.8 për qind ndërsa shpenzimet në masën 92.9 për qind. Gjithësesi, pritet që për pjesën e mbetur të vitit, kërkesat e buxhetit për likuiditet të rriten dhe ashtu si në vitet e kaluara do të arrijnë pikun e tyre në muajin dhjetor. Pritet që në fund të vitit deficitit buxhetor të arrijë nivelin 9.4 për qind të PBB-së nga i cili 2.1 për qind e PBB-së do të jetë i financuar me të ardhurat e privatizimit dhe 2.8 për qind e PBB-së nga ana e sistemit bankar.

### 1.5. Zhvillimet në çmimet e konsumit.

Në vitin 2001 ecuria e çmimeve të konsumit ishte e ndryshme nga viti 2000. Në mënyrë të vazhdueshme, inflacioni erdhi në rritje duke arritur nivelin më të lartë në muajin korrik, prej 5.6 për qind, nivel i cili kalonte ndjeshëm kufirin e sipërm të intervalit objektiv prej 4 për qind. Ndërsa në dy muajt vijues inflacioni vjetor ka ardhur në reduktim për të arritur në fund të muajit tetor në 1.8 për qind. Ndërkohë që në muajin nëntor 2001, ai regjistroi shifrën 2.8 për qind në nivel vjetor apo 1.9 për qind si ndryshim mujor.





Kështu, në ndryshim nga viti 2000, por dhe nga tendencat e përgjithshme të vërejtura në vite, në vitin 2001 është manifestuar:

- ndikim më i pakët i efekteve sezonale, sidomos i periudhës së stinës së verës. Të njëjtën veçori paraqiti edhe kursi i këmbimit të monedhës së vendit kundrejt dollarit amerikan dhe euros. Në tërësi, leku mbiçmohet në stinën e verës për t'u nënçmuar më pas. Në fakt, ka patur një zhvendosje të kësaj sjelljeje, ku leku shqiptar nuk u mbiçmua me të njëjtin intensitet gjatë periudhës së verës, përkundrazi në momente të caktuara u nënçmua. Ndërkohë stina e vjeshtës solli mbiçmim të lekut, ndryshe nga vite të mëparshme si pasojë e nënçmimit të dollarit amerikan në tregjet botërore pas sulmit të 11 shtatorit dhe më tej si pasojë e afrimit të datës së hyrjes në qarkullim të euros fizike;
- nivel mesatarisht më i lartë i inflacionit në vitin 2001 krahasuar me vitin 2000 (rreth 3.7 pikë përqindjeje);
- ekzistenca e një sërë faktorëve *shock* të krahut të ofertës, të cilët pasuan njëri-tjetrit duke u shndërruar në faktorë me veprim të përhershëm. Më të spikaturit ndër këta faktorë kanë qenë: konflikti në Maqedoni dhe bllokimi i importeve, sidomos i frutave dhe perimeve, rritja e shpallur e pagave buxhetore dhe e pensioneve në muajin korrik, përqendrimi i shpenzimeve buxhetore të gjashtë muajve të parë të vitit, në muajt maj e qershor apo reduktimi i prodhimit bujqësor të vendit;
- pritshmëri për rritje të presioneve inflacioniste për muajin dhjetor si pasojë e festave të fundvitit, periudhë kur zakonisht rriten ndjeshëm çmimet si dhe e rritjes së çmimit të energjisë elektrike. Nga ana tjetër, ulja e çmimeve të naftës, të produkteve bujqësore

dhe të lëndëve të para në tregjet ndërkombëtare në afat të shkurtër pritet të ketë patur një ndikim pozitiv në mbajtje të çmimeve në nivele të ulëta. Kjo mund të kompensojë diçka rritjen e presioneve inflacioniste të muajit dhjetor. Megjithatë, duhet theksuar që rritja e çmimit të energjisë elektrike nuk ka ndikim të drejtpërdrejtë të konsiderueshëm në inflacion brenda vitit 2001 për shkak të peshës së ulët që ka ky zë në shportën e mallrave. Efektet e rritjes së këtij çmimi do të jenë më të ndjeshme në vitin 2002.

**Tabela 7: Seritë mujore të normës së inflacionit (në %).**

Muajt	1998	1999	2000	2001
Janar	3.46	0.91	0.63	-1.30
Shkurt	1.81	-0.61	-0.6	-1.30
Mars	1.16	-0.29	-1.11	0.30
Prill	1.61	0.01	0.72	0.85
Maj	-0.19	-0.64	0.67	0.20
Qershor	-1.74	-2.28	-2.1	-0.70
Korrik	-2.01	-1.30	-2.7	-2.20
Gusht	0.41	-0.28	0.39	-1.00
Shtator	1.45	0.10	1.7	1.10
Tetor	0.26	0.39	1.3	-0.40
Nëntor	0.21	0.78	0.7	1.9
Dhjetor	2.05	2.25	4.6	

Burimi: INSTAT.

Në këto kushte, Banka e Shqipërisë gjykon se, pavarësisht kapërcimeve të tilla, gjendja është disi e normalizuar dhe pritshmëritë e saj për inflacionin, deri në fund të vitit, nuk do të kalojnë vlerën 2-4 për qind.

### **1.6. Ndikimi i ekonomisë botërore në ekonominë shqiptare.**

Ngadalësimi i ekonomisë botërore, sidomos pas sulmit të 11 shtatorit, pritet të ndikojë edhe në vendin tonë. Duke marrë parasysh shkallën e ulët të hapjes së ekonomisë shqiptare, madhësia e ndikimit do të varet nga shkalla me të cilën do të preken ekonomitë partnere me Shqipërinë, kryesisht Italia dhe Greqia.

Fushat kryesore ku mendohet të ndikojnë zhvillimet e ekonomisë botërore janë:

- Turizmi. Në tërësi pritet një reduktim i aktivitetit turistik. Nisur nga fakti që Rajoni i Ballkanit vazhdimisht është klasifikuar si rajon me rrezik, pritet që reduktim të ketë edhe turizmi në



Shqipëri.

- Investimet e huaja direkte, gjithashtu, mund të pësojnë njëfarë tkurrjeje për shkak të zhvendosjes së vëmendjes së vendeve që janë në gjendje për të investuar si dhe për shkak të programeve që kanë ndërmarrë vendet e zhvilluara për të mbështetur ekonominë e brendshme. Megjithatë, pritet që ekonomia shqiptare të mos vuajë ndjeshëm pasi ajo, në mënyrë të vazhdueshme, është përballur me investime të huaja të reduktuara.
- Rënia e çmimeve të produkteve bujqësore, metaleve dhe naftës. Kjo mund të ndikojë në një nxitje të importeve të këtyre produkteve duke dekurajuar eksportet. Për pasojë, mund të ketë presion për thellim të deficitit tregtar, ndërkohë që në periudhë afatshkurtër mund të mbajë çmime të ulura në tregun e vendit.
- Prurjet e valutës nga emigrantët. Situata ekonomike mund të reduktojë kërkesën për punësim në vendet e tjera dhe nga kjo mund të vuajnë drejtpërsëdrejti emigrantët shqiptarë. Për pasojë, mund të vërehen reduktime në prurjet e valutës prej tyre.

## 2. ZHVILLIMET NË POLITIKËN MONETARE

Gjatë vitit 2001 sektori financiar i ekonomisë shqiptare ka shënuar zhvillime pozitive. Cilësia dhe aktiviteti i këtij sektori janë rritur dhe kanë evoluuar, duke qenë më afër nevojave dhe zhvillimeve të ekonomisë shqiptare. Duhet theksuar se këto zhvillime pozitive reflektojnë kryesisht zgjerimin dhe përmirësimin e efektivitetit të sistemit bankar shqiptar, në një kohë që segmenti i tregjeve të kapitaleve mbetet ende i pazhvilluar.

Tregues të kësaj ecurie pozitive të tregjeve të parasë, ku sistemi bankar ka pa dyshim, peshën më të madhe, janë rritja e mbështetjes së bizneseve shqiptare me kredi, rritja e numrit dhe e pjesëmarrësve në transaksionet e tregut ndërbankar, rritja e shkallës së reagimit të tregjeve financiare ndaj vendimeve të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë etj..

Integrimi në rritje i sektorit financiar të ekonomisë me sektorët realë të saj ka bërë që zhvillimet monetare gjatë këtij viti të reflektojnë më nga afër zhvillimet në ekonominë reale.

Të dhënat e deritanishme të këtij viti tregojnë se mbështetja e ekonomisë me kredi është më e madhe krahasuar me vitet e tjera, besimi i publikut ndaj sistemit bankar është në rritje duke sjellë, megjithë uljen e normave

të interesit, rritjen e kursimeve të depozituara në të dhe përmirësimin e gjendjes së likuiditetit dhe të treguesve të performancës së tij. Pozicioni valutor i sistemit bankar është konsoliduar më tej duke ndihmuar në stabilitetin e vlerës së lekut kundrejt valutave kryesore, ndërsa tregu ndërbankar ka patur një aktivitet më afër atij të pritshëm. Megjithatë, duhet patur parasysh që niveli i kreditimit nga sistemi bankar ende nuk i përgjigjet në shkallën e duhur nevojave që ka ekonomia shqiptare.

Të gjitha këto zhvillime nuk i kanë përcjellë ekonomisë presione inflacioniste megjithë faktin që rritja e ofertës monetare ka qenë mbi parashikimin fillestar të saj. Stabiliteti i treguesve makroekonomikë dhe ndikimi pozitiv i tij në pritjet e ekonomisë shqiptare kanë bërë që kërkesa për mjete monetare të rritet përtej parashikimeve. Rritja e inflacionit gjatë muajve të verës, e cila erdhi në masën më të madhe si pasojë e fenomeneve *shock* të ofertës dhe si pasojë e rritjes së shpenzimeve qeveritare, me dobësimin e fenomeneve të përmendura dhe reagimin në kohë të Bankës së Shqipërisë, u arrit të kontrollohej me sukses.

Më poshtë dëshiroj të ndalem shkurtimisht në treguesit kryesorë monetarë, duke dashur të theksoj ndikimin e tyre në zhvillimin e ekonomisë dhe qëndrimin e Bankës së Shqipërisë ndaj zhvillimeve monetare.

## **2.1. Kërkesa e ekonomisë për mjete monetare.**

Kërkesa e brendshme e ekonomisë shqiptare për fonde nga sistemi bankar, krahasuar me vitin e kaluar, ka patur një qëndrueshmëri nga pikëpamja sasiore, por ajo ka shënuar një zhvendosje të brendshme, nga financimi i deficitit buxhetor në financim të sektorëve prodhues të ekonomisë.

***Kredia për ekonominë***, në njëfarë mënyre, është treguesi monetar i cili pasqyron më mirë gjendjen e ekonomisë, rritjen apo rënien e saj, duke përbërë shpesh një faktor përcaktues të gjendjes aktuale dhe të pritshme të saj. Mungesa e tregjeve kapitale si burime alternative të financimit apo kapitalizimit të bizneseve, i jep akoma më rëndësi kredisë bankare në ekonominë shqiptare. Megjithatë, interpretimi i këtij treguesi nuk do të ishte i saktë, në qoftë se nuk do të merrte parasysh edhe specifikat konkrete të tregut shqiptar të huamarrjes, treg ku marrëdhëniet midis bankave dhe klientëve të tyre nuk janë të vendosura mbi bazën e një historiku dhe një treg ku ekziston një mungesë institucionesh që të ndihmojnë apo lehtësojnë këtë proces dhe mangësi të tjera strukturore.



Në kushtet e Shqipërisë ecuria e kredisë për ekonominë reflekton dhe është e lidhur me një numër të madh faktorësh. Zhvillimi i sistemit bankar, rreziku i kredidhënies, i cili në një këndvështrim më të përgjithshëm, është i lidhur edhe me garantimin e zbatimit të ligjit, rritja e kulturës ekonomike të bizneseve dhe ndërgjegjësimi i tyre për përparësitë e mbështetjes në kredinë bankare për zhvillimin e biznesit, rregullimi i raporteve dhe eliminimi i deformimeve në tregjet financiare shqiptare – zvogëlimi i rolit dominues të kërkesës së qeverisë në tregjet e parasë për financim si dhe eliminimi apo zbutja e pozicionit përcaktues të normave të interesit të bonove të thesarit në sistemin bankar, ndikojnë direkt në ecurinë e kredisë për ekonominë. Të gjitha këto probleme kërkojnë kohë për t'u zgjidhur. Megjithatë, ky vit ka patur një ecuri pozitive të kredisë për ekonominë, si në drejtim të kredisë së re të akorduar, ashtu edhe në rritjen e tepricës të saj.

Gjendja e kredisë së sistemit bankar për ekonominë si dhjetëmujor ka arritur në nivelin 31.8 miliardë lekë, ndërsa vetëm kredia e re e dhënë gjatë kësaj periudhe është 27.9 miliardë lekë. Ajo është rritur me 5.9 miliardë lekë gjatë dhjetë muajve të parë të vitit duke përbërë afërsisht 87 për qind të shifrës së parashikuar nga Banka e Shqipërisë në programin monetar të rishikuar. Deri në fund të muajit tetor, rritja në terma relativë e saj nga fillimi i vitit ishte 23.4 për qind.

**Tabela 8: Rritja vjetore në përqindje e kredisë për ekonominë.**

	1998	1999	2000	2001
Rritja vjetore	16.3	6.7	35.7	23.4

Rritja mesatare mujore e tepricës së stokut të kredisë gjatë 10 muajve të parë të vitit është rreth nivelit 594 milionë lekë, megjithatë duhet thënë se ky ritëm ka qenë i ndryshëm. Të dhënat tregojnë se në dy muajt e parë të vitit, teprica e kredisë për ekonominë është ulur me 0.1 miliardë lekë, ndërkohë që mesatarja mujore e rritjes së stokut në periudhën pasuese është 664 milionë lekë, duke qenë më e lartë se rritja mesatare mujore e parashikuar në programin monetar (567 milionë lekë).

**Tabela 9: Ecuria e disa treguesve kryesorë në vite.**

	1999	2000	Tetor 2001
Oferta e parasë (në miliardë lekë)	292.9	328.1	365.4
Kredia e brendshme (në % ndaj M3)	80.3	76.3	70.7
-Kredia për Qev. (në % ndaj M3)	73.5	68.4	62.0
-Kredia për ekonominë (në % ndaj M3)	6.8	7.9	8.7
Kredia për ekon. (në % ndaj PBB)	3.9	4.8	5.4
Kredia për ekon. (në % ndaj tot të aktiveve)	9.4	9.5	10.5
Raporti kredi/depozita (në %)	9.4	11.3	12.3

Të dhënat e tabelës së mësipërme tregojnë se kredia për ekonominë është duke marrë një rol gjithnjë e më të madh si burim i kërkesës së parasë, në një kohë që pesha e kredisë për qeverinë është në rënie.

**Tabela 10: Teprica e kredisë si sistem bankar (në miliardë lekë).**


	Dhjetor '00	Mars '01	Qershor '01	Tetor'01
K. afatshkurtër	10.4	10.8	12.3	14.8
K. afatmesme	8.1	7.8	8.3	9.2
K.afatgjatë	7.4	7.9	8.0	7.9
Sektori shtetëror	1.5	1.1	1.1	1.7
Sektori privat	24.4	25.4	27.5	30.1
Lekë	10.3	10.5	11.0	12.2
Valutë	15.6	16.0	17.6	19.6
<b>TOTALI</b>	<b>25.9</b>	<b>26.5</b>	<b>28.6</b>	<b>31.8</b>

Megjithë zhvendosjet e shpeshta që kanë statistikave monetare, si pasojë e procesit të rikapitalizimit të bankave shtetërore dhe pastrimit të bilancit të tyre nga kreditë e këqija, prirjet kryesore të aktivitetit të kreditimit janë të qarta.

Kredia në valutë në tepricën e kredisë përbën 62 për qind të saj, duke shënuar një rritje me 1.4 pikë përqindjeje në krahasim me fundin e vitit 2000. Preferenca e kreditimit në valutë, e shfaqur si nga ulja e vazhdueshme e peshës së tepricës së kredive në lekë ashtu edhe nga të dhënat lidhur me kredinë e re, ka dy arsye kryesore:

- së pari, ka të bëjë me faktin se normat e interesit të kredive në valutë janë më të ulëta, mesatarisht 3 – 5 pikë përqindjeje sesa kreditë në lekë në të njëjtin afat maturimi; dhe
- së dyti, bankat të cilat zotërojnë pjesën më të madhe të depozitave në lekë ose e kanë të ndaluar kredidhënien për arsye kujdesi, si Banka e Kursimeve, ose sapo kanë filluar të lëvrojnë kredi, si Banka Kombëtare Tregtare.

Ashtu si dhe në vitin e kaluar edhe gjatë vitit 2001, sistemi bankar ka akorduar më shumë kredi në terma afatshkurtër. Vrojtimet e Bankës së Shqipërisë tregojnë se ekziston një preferencë e bankave ndaj kredisë afatshkurtër për shkak të rrezikut të ulët që mbart në vetvete. Kreditimi i ekonomisë në terma afatshkurtër është një nga faktorët kryesorë që mban të ulët rritjen e stokut të kredisë.



**Grafiku 3. Ecuria e kredisë së re.**

Megjithë rëndësinë që ka analiza e tepricës së kredisë për ekonominë, nga pikëpamja e kërkesës së ekonomisë për para, analiza e ecurisë së kredisë së re është një tregues më i mirë i dinamikës së procesit të kreditimit. Duke ju përmbajtur krahasimeve në terma relativë, periudha dhjetëmujore (janar - tetor 2001) ka regjistruar një rritje të kredisë së re në masën 48 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ose është pothuajse e barabartë me totalin e kredisë së re të dhënë gjatë gjithë vitit të kaluar.

Në vlerë absolute, kreditë e reja gjatë kësaj periudhe kanë arritur shifrën 27.9 miliardë lekë. Kredia e re e akorduar për këtë periudhë paraqet disa karakteristika, të cilat shfaqen edhe në përbërjen e tepricës së kredisë. Ajo është lëvruar në masën më të madhe, 98 për qind, në sektorin privat dhe vetëm 2 për qind në sektorin publik. Kjo ka bërë që teprica e stokut ndaj ndërmarrjeve të sektorit publik të jetë e pandryshuar. Kredidhënia vazhdon të jetë në masën më të madhe, 75 për qind, në valutë dhe e përqëndruar në afatet e shkurtra të maturimit. Përbërja e kredisë së re, sipas afatit të maturimit është: 66.3 për qind kredi afatshkurtër, 27 për qind kredi afatmesme dhe 6.7 për qind kredi afatgjatë. Në tabelën e mëposhtme jepet një detajim më specifik i veçorive të kredisë së re dhe të ndikimit gradual të saj në strukturën e tepricës së kredisë.

**Tabela 11: Veçoritë e kredihënies (në përqindje).**

	Teprica e Kredisë				Kredia e re			
	T1	T2	T3	Tetor	T1	T2	T3	Tetor
K. afatshkurtër	39	42	46	46.6	62	65	66	77
K. afatmesme	32	31	29	28.6	25	30	29	15
K.afatgjatë	29	27	25	24.8	13	5	5	8
Sektori shtetëror	10	9	5	5	5	2	0	0
Sektori privat	90	91	95	95	95	98	100	100
Lekë	42	41	36	38.4	23	28	17	49
Valutë	58	59	64	61.6	77	72	83	51
Teprica e kredisë (në mld lekë)	26.5	28.6	31.2	31.8	4.7	8.2	11.4	3.5

Struktura kohore e kredisë së re fsheh edhe një veçori tjetër të saj – faktin që ajo është e orientuar ndaj bizneseve të vogla ndërsa projektet dhe planbizneset afatgjata gjejnë ende pak mbështetje në kredinë bankare. Këtë e tregon edhe shpërndarja sektoriale e kredisë e paraqitur në tabelën e mëposhtme.

**Tabela 12: Akordimi i kredisë sipas degëve (në % ndaj tepricës së kredisë)<sup>1</sup>**


Nr	Degët e ekonomisë	Dhjetor '00	Mars '01	Qershor' 01	Shtator'01
1	Bujqësia, Gjuetia dhe Silvikultura	1	1	1	1.1
2	Peshkimi	1	1	1	1
3	Industria Nxjerrëse	1	1	1	1.9
4	Industria Përpunuese	17	17	20	19.6
5	Prodhimi, Shpërndarja e Energjisë Elektrike e Gazit dhe e Ujit	9	9	5	4.3
6	Ndërtimi	25	25	27	21.5
7	Tregtia, Riparimi i Automobilitave dhe Artikujve Shtëpiakë	27	25	24	29.4
8	Hotele dhe Restorante	4	7	5	4.9
9	Transporti dhe Telekomunikacioni	3	1	3	2.3
10	Aktivitetet Financiare		1	0	0.1
11	Pasuritë e Patundshme	5	6	7	9.4
12	Shëndeti dhe Veprimtaritë Sociale	3	3	1	1.3
13	Shërbime kolektive, Sociale dhe Personale	3	3	3	1.8
14	Të tjera	0	0	2	1.5
	TOTALI	100	100	100	100

<sup>1</sup> Ky informacion përgatitet një herë në tre muaj.





Degët e ekonomisë që mbështeten më shumë me kredi vazhdojnë të mbeten tregtia, ndërtimi dhe industria përpunuese. Gjithashtu, duhet theksuar se procesi i kreditimit ka një ritmikë vjetore jo të njëtrajtshme, duke bërë që analizat dhe krahasimet midis periudhave, të humbin diçka nga rëndësia dhe aftësia shpjeguese e tyre. Kështu, kredia në dy muajt e parë të vitit ka qenë në rënie ndërsa në periudhën e verës, edhe në përgjigje të rritjes së shpenzimeve qeveritare, ajo ka regjistruar vlerën më të madhe në muajt qershor dhe shtator me 3.6 dhe 4.8 miliardë lekë, ndërkohë që mesatarja mujore e akordimit të kredisë së re është 2.8 miliardë lekë. Shpërndarja mujore e kredisë së re paraqitet në grafikun e mëposhtëm.



**Grafiku 4. Ecuria mujore e kredisë së re (në milionë lekë).**

Në fund të muajit tetor 2001, niveli i **kredive me probleme** si sistem bankar është 34 për qind i tepricës së kredisë, nga 49 për qind që ishte në fund të vitit 2000 (duke përfshirë dhe ATK). Krahasuar me tremujorin e dytë, niveli i kredive me probleme në vlerë absolute është rritur me 283 milionë lekë (përfshuar ATK). Kreditë me probleme në fund të dhjetëmujorit kanë arritur në nivelin 12 për qind të tepricës së kredisë si sistem, duke pësuar një ulje krahasuar me muajin qershor 2001 prej 31 pikë për qind<sup>2</sup>.

Megjithë luhatjet mujore përgjithësisht, **normat e interesit** të kredive kanë qenë në rënie. Rënia e këtyre normave ka qenë veçanërisht e pranishme në gjashtëmujorin e parë të vitit dhe për afatet e maturimit më të mëdha se gjashtë muaj. Në periudhën pasuese, si pasojë e ndryshimit të qëndrimit të politikës monetare, rënia e normave të interesit është më e moderuar.

<sup>2</sup> Kjo rënie e madhe ka ardhur si pasojë e kalimit të një pjese të portofolit të kredisë së Bankës së Kursimeve, pranë ATK dhe llogaritjet janë kryer duke përfshuar të gjithë pjesën e tepricës së kredisë që trajtohet në ATK (BTA, BKT dhe BK).

**Tabela 13: Normat e interesit të ponderuar për kreditë e akorduara në lekë.**

	Dhj'99	Dhj'00	Mar '01	Qer'01	Korr'01	G '01	Shtat'01	Tet'01
Kreditë deri 6 muaj	21.7	21.19	20.92	24.00	23.46	24.00	14.64	15.49
Kreditë 6m-1vit	25.8	23.70	16.10	13.98	15.70	13.93	13.87	16.74
Kreditë 1-3 vjet	26.8	23.74	22.19	14.58	17.91	18.90	18.17	19.10
Kreditë mbi 3 vjet	22.2	27.00	15.58	15.22	13.33	14.00	17.00	14.00
Kreditë gjithsej	25.46	23.56	17.62	14.36	16.89	14.72	14.67	17.55

**Tabela 14: Normat e interesit të ponderuar për kreditë e akorduara në valutë për vitin 2001.**

Periudha	Në usd	Në euro
Janar	10.07	11.71
Mars	9.52	8.20
Qershor	10.28	7.55
Shtator	7.46	6.64
Tetor	8.85	8.58

Sidoqoftë, vlen të theksohet se kredi në lekë akordojnë një numër shumë i vogël bankash, dhe si të tilla ato bëhen dhe përcaktuese të interesit të ponderuar për kredinë e akorduar në lekë. Duke qenë se bankat kanë nivele mjaft të ndryshme të interesave të kredive, ecuria e normës së ponderuar të sistemit ndikohet ndjeshëm nga pesha që ato zënë në periudha të dhëna në kreditë e reja.

Megjithë rënien e normave të interesit në tregun e kredive, nuk është vërejtur ndonjë ndikim në rritjen e kërkesës për to, duke treguar një elasticitet të ulët të kredive ndaj normave të interesit. Kjo dëshmon edhe një herë që fenomeni i kredihënies përballet kryesisht me pengesa strukturore të ekonomisë shqiptare dhe të sistemit financiar dhe përbën një pengesë të madhe në hartimin dhe zbatimin e një politike monetare efektive nga Banka e Shqipërisë.

**Kërkesa e qeverisë** për financim të deficitit buxhetor të saj nga sistemi bankar ka qenë larg vlerave dhe shpërndarjes mujore të parashikuar në programin monetar. Në kushtet kur qeveria mbetet kërkuesi kryesor i fondeve në ekonominë shqiptare, kërkesa e ulët e saj ka ndikuar në rritjen e likuiditetit të tepërt në sistemin bankar, i cili arriti nivelin maksimal në muajt prill-maj, siç tregohet dhe në tabelën e mëposhtme. Nga ana tjetër, shpërndarja pak e rregullt e këtij financimi dhe përqëndrimi më i madh i tij në muajt qershor-korrik, përveç ndikimeve që japin në kërkesën agregate të ekonomisë dhe në inflacion, rritin luhatjet në tregun e parasë dhe vështirësojnë parashikimin e saktë të likuiditetit dhe të ndërhyrjeve të Bankës së Shqipërisë në to, në përputhje me politikën monetare të saj.

**Tabela 15: Ecuria kumulative mujore dhe e financimit të tij në vitin 2001 (miliardë lekë).**

	Mars	Qershor	Shtator	Tetor
Deficiti	3.99	13.81	20.50	21.60
Financimi	6.14	13.94	22.88	23.55
I brendshëm	2.39	9.24	18.13	18.97
Të ardhura privatizimi	2.85	8.99	11.71	11.71
Bono thesari	-0.46	0.25	6.42	7.29
I jashtëm	3.74	4.5	4.56	4.57
Dep. në BSH	2.14	0.13	2.38	1.96

Në arritjen e këtij rezultati fiskal kanë ndikuar të ardhurat e privatizimit, të cilat u përqëndruan në pjesën e parë të vitit dhe kanë arritur në 2.9 për qind të PBB-së dhe, në një masë më të vogël, financimi i deficitit nga burime të huaja, i cili arriti në 1.1 për qind të PBB.

Pjesa më e madhe e financimit të deficitit buxhetor është bërë nga bankat tregtare, ndërsa Banka e Shqipërisë nuk ka patur një pjesëmarrje aktive në këto ankande. Portofoli i saj i bonove të thesarit dhe pretendimet e saj neto ndaj qeverisë janë ulur gjatë vitit 2001.

**Tabela 16: Normat e interesit të bonove të thesarit (në %).**


Muajt	Janar	Mars	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor
3-mujore	7.75	7.57	7.48	7.49	7.74	7.94	7.99	8.00
6-mujore	11.09	10.14	9.23	9.24	9.38	9.54	9.77	9.80
12-mujore	11.78	11.14	9.91	9.95	10.14	10.48	10.45	10.49

Normat e interesit të ankandit primar të bonove të thesarit si pasojë e kërkesës së ulët të qeverisë dhe likuiditetit të tepërt të sistemit bankar kanë qenë në ulje gjatë pjesës së parë të vitit. Këto norma interesi janë një objektiv operacional i Bankës së Shqipërisë dhe shërbejnë si një tregues i hershëm i bilancit të ofertës dhe kërkesës për mjete likuide në ekonomi. Ulja e vazhdueshme e tyre, në pjesën e parë të vitit, u shoqërua me presione të moderuara inflacioniste në pjesën e parë të vitit. Në këtë periudhë kjo është ndihmuar edhe nga politika monetare e Bankës së Shqipërisë, e cila ka patur një qëndrim neutral ndaj normave të interesit. Megjithatë, kërcimi i inflacionit në periudhën qershor-korrik, periudhë në të cilën normat e interesit të bonove të thesarit arritën minimumin e tyre, tregoi se politika monetare e Bankës së Shqipërisë kishte nevojë të modifikohej. Rritja e inflacionit në muajt qershor dhe korrik e shtyu Bankën e Shqipërisë të kalonte në një politikë shtrënguese monetare. Në përgjigje të saj, normat e interesit të bonove të thesarit kanë qenë në rritje në të tre maturitetet, gjatë pjesës së dytë të vitit, duke ndikuar në stabilizimin e normave të interesit në ekonomi.

## 2.2. Oferta monetare dhe objektivat sasiorë të Bankës së Shqipërisë.

Rritja e ofertës monetare, gjatë gjysmës së parë të vitit ka qenë brenda parashikimeve, ndërsa pas muajit qershor vihet re një rritje e këtij treguesi përtej vlerave të programuara. Kështu, në fund të muajit shtator agregati M3 rezultoi 5.8 miliardë lekë përtej parashikimit të bërë në programin monetar.

Rritja e parasë ka qenë në masën më të madhe në formën e rritjes së depozitave në sistem dhe si e tillë nuk ka shkaktuar presione inflacioniste në ekonomi. Ky fakt tregon për një rritje të kërkesës për para reale në ekonomi. Në përputhje me këtë tendencë, Banka e Shqipërisë bëri edhe rishikimin e projeksionit të saj për rritjen vjetore të ofertës monetare, duke e rritur atë nga 11.26 për qind në 15.4 për qind.



**Grafiku 5. Normat e rritjes vjetore të treguesve monetarë.**

Në muajt korrik dhe gusht norma e rritjes vjetore të parasë jashtë bankave ka qenë ndjeshëm mbi nivelin mesatar të rritjes vjetore (18.2 dhe 18.7 për qind respektivisht) si rezultat i ndikimit të shpenzimeve të qeverisë të bëra në muajin paraardhës. Nga ana tjetër, ajo është shoqëruar me një rritje të inflacionit në këta muaj dhe shkeljen e objektivit të Bankës së Shqipërisë për nivelin e mjeteve të brendshme neto të saj. Në muajin shtator dhe më tej kjo rritje ka ardhur pranë niveleve mesatare duke eliminuar likuiditetin e tepërt në treg, i cili mundësoi edhe rritjen e inflacionit në muajt qershor-korrik.

Si pasojë e uljes së interesave për depozitat në lekë, normat e rritjes së tyre kanë qenë më të ulëta se ato të përbërësve të tjerë të ofertës monetare duke sjellë ujen e peshës së tyre ndaj M3. Ngushtimi i diferencës së normave të interesit të depozitave në lekë dhe atyre në



valutë, ka bërë që të rritet pesha e këtyre të fundit në ofertën monetare. Aktualisht, këto depozita përbëjnë 21.6 për qind të ofertës monetare.

Rritja e normave të interesit për repot në muajin gusht u shoqërua edhe me një rritje të lehtë të normave të interesit të depozitave në lekë, megjithatë kjo nuk është shoqëruar me një ndryshim të tendencës së uljes së peshës së tyre brenda ofertës monetare në favor të përbërësve të tjerë të saj.

Në muajin qershor, niveli i bazës monetare u rrit ndjeshëm mbi parashikimin, kryesisht si rezultat i nivelit të lartë të rezervave të tepërta në lekë dhe i rritjes së parasë jashtë bankave në këtë muaj. Më pas, niveli i bazës monetare ka qëndruar konstant, duke ndihmuar në respektimin e objektivave sasiorë të Bankës së Shqipërisë. Kërkesa e ulët e qeverisë për financimin e deficitit të saj dhe politika e Bankës së Shqipërisë për uljen e rezervave të tepërta në sistem, kanë kontribuar në kontrollin e nivelit të bazës monetare.

**Objektivat sasiorë** të Bankës së Shqipërisë, me përjashtim të mjeteve të brendshme neto të Bankës së Shqipërisë në muajin qershor, janë përmbushur gjatë gjithë vitit.

Tabela 17: Realizimi i objektivave sasiorë të Bankës së Shqipërisë (ndryshimi nga objektivi).

	Mars	Qershor	Shtator
Rezervat ndërkombëtare neto të B. Sh. (në mld lekë)	18.3	12.8	28.2
Mjetet e brendshme neto të B.Sh. (në mld lekë)	-6.2	4.3	-1.2
Kredia neto e sistemit bankar për Qeverinë (në mln usd)	-7.5	-17.6	-15.9

Ecuria pozitive e bilancit të pagesave, financimi i huaj i deficitit dhe të ardhurat e privatizimit të qeverisë kanë ndikuar në rritjen e rezervës valutore të saj, duke qenë gjatë gjithë periudhës mbi objektivin dysheme të tyre. Kërkesa brenda niveleve të programuara e qeverisë për financim nga sistemi bankar, ka bërë që ky i fundit të mos kalojë limitin tavan të përcaktuar nga objektivi i kredisë neto për qeverinë.

Objektivi i mjeteve të brendshme neto të Bankës së Shqipërisë u shkel në muajin qershor. Në këtë shkelje rolin parësor e ka patur vendimi i Bankës së Kursimeve për të mbajtur likuiditet të tepërt të paineduar, duke rritur kështu bazën monetare. Po kështu, në rritjen e mjeteve të brendshme neto në këtë periudhë ka ndikuar edhe rritja e parasë jashtë bankave, e cila arriti nivelin maksimal në këtë muaj. Muajt pasues sollën zhvillime më normale dhe këta objektiva rezultuan përsëri brenda niveleve të parashikuara.

Ndërkohë, në marrëveshje me misionin e FMN, i cili ishte i pranishëm gjatë muajit tetor, është përfunduar rishikimi i këtyre objektivave për tremujorin e fundit të vitit dhe vitin e ardhshëm. Në këto takime u finalizuan edhe projeksionet e zhvillimeve monetare për periudhat në fjalë, të cilat do të marrin formë të plotë në programin monetar të Bankës së Shqipërisë për vitin e ardhshëm.

### **2.3. Programi monetar i vitit 2001.**

Programi monetar i Bankës së Shqipërisë për vitin 2001 parashikonte një rritje të ofertës monetare në masën 11.26 për qind, duke u bazuar në parashikimin e rritjes së ekonomisë 7.3 për qind, në objektivin e Bankës së Shqipërisë për inflacionin brenda kufijve 2 - 4 për qind dhe në një kërkesë të qëndrueshme të ekonomisë për mjete monetare. Rritja e ofertës monetare do të mbështeste rritjen e kreditimit të ekonomisë në masën 8.1 miliardë lekë, financimin e deficitit buxhetor nga sistemi bankar në masën 17.8 miliardë lekë dhe do të përmirësonte pozicionin valutor të sistemit bankar.

Në fakt, të dhënat treguan se rritja e ofertës monetare ishte më e madhe nga sa pritej, veçanërisht në pjesën e dytë të vitit. Në muajin tetor oferta monetare arriti 365.4 miliardë lekë duke qenë 5 miliardë lekë mbi parashikimin.

Burimi kryesor i kësaj rritjeje të ofertës monetare ishte rritja e mjeteve valutore neto të sistemit me 21.3 miliardë lekë, ndërkohë që financimi i deficitit buxhetor nga sistemi bankar, në fund të muajit tetor, ishte vetëm 3.5 miliardë lekë ose 11.3 miliardë më pak se parashikimi, ndërsa kredia për ekonominë ishte rritur me 5.8 miliardë lekë ose 0.95 miliardë lekë nën parashikimin.

Duke u nisur nga kjo ecuri e treguesve monetarë, Banka e Shqipërisë bëri një rishikim të programit të saj monetar për tremujorin e fundit, për ta përafëruar atë me zhvillimet reale. Sipas projeksioneve të programit të rishikuar, oferta monetare do të rritet 15.4 për qind dhe brenda saj depozitat në valutë do të rriten me 26.1 për qind, duke arritur në 21.2 për qind të ofertës monetare. Kredia për ekonominë do të rritet me 6.8 miliardë lekë, ndërsa financimi i deficitit buxhetor nga sistemi bankar do të jetë 16.7 miliardë lekë.



### **3. ZHVILLIMET VALUTORE**

#### **3.1. Rezervat valutore.**

Gjatë vitit 2001, vlera e rezervës valutore që administrohet nga Banka e Shqipërisë, është rritur.

Në fillim të vitit, vlera e rezervës valutore bruto, ishte 607.7 milionë dollarë amerikanë, ndërsa në fund të muajit nëntor 2001, vlera e saj ishte 694.1 milionë dollarë amerikanë. Rritja e rezervës valutore, e shprehur në vlerë absolute ishte 86.4 milionë dollarë amerikanë. E shprehur në mënyrë relative, kjo rritje ishte 14.2 për qind.

Gjatë këtij viti, në vijim të zbatimit të politikës dhe mënyrës së administrimit të rezervës valutore, miratuar me vendimin nr.70, datë 02.08.2000 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, procesi i administrimit të rezervës valutore ka njohur ndryshime. Është shtuar numri i instrumenteve financiare ku kryhet investimi i rezervës ndërkombëtare si edhe është rritur kohëzgjatja e investimeve të kryera. Staf i angazhohet në këtë proces, është shtuar me njerëz të rinj dhe në të njëjtën kohë struktura e tij ka pësuar ndryshime. Të gjitha këto, janë në vijim të një qëndrimi të ri të Bankës së Shqipërisë për një administrim më të studiuar dhe më aktiv të fondeve në valutë, duke garantuar sigurinë e vlerave të investuara. Së fundi është miratuar krijimi dhe funksionimi i Komitetit të Investimit, i cili do të rrisë aftësinë vendimmarrëse në procesin e investimit të rezervës valutore.

Të ardhurat nga investimi i rezervës ndërkombëtare varen, në masën më të madhe, nga ecuria e tregjeve ndërkombëtare dhe e ekonomive kryesore botërore. Viti 2001, ka qenë një vit i vështirë për të gjithë ekonominë botërore dhe veçanërisht për ekonominë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ngadalësimi ekonomik, që u bë i dukshëm me fillimin e këtij viti, iu bashkëngjiti edhe efekti tepër negativ i sulmeve terroriste në muajin shtator. Si rezultat, për rigjallërimin e ekonomisë Banka Qendrore e SHBA, Rezerva Federale, ka ndërmarrë që nga fillimi i vitit një cikël uljesh të normës së interesit të tregut, i cili nuk ka precedent në historinë e ekonomisë amerikane. Mjafton të përmendim faktin që me fillimin e vitit, në takime të posaçme të parashikuara por edhe jashtë tyre, norma e interesit afatshkurtër të tregut në SHBA është ulur me 4.75 për qind, në nivelin aktual prej 1.75 për qind. Pritjet janë, që vështirësitë të cilat vihen re në sektorin e prodhimit, në rritjen e papunësisë, në rënien e investimeve private në ekonomi etj., të

vazhdojnë edhe në gjysmën e parë të vitit të ardhshëm. Norma e interesit afatshkurtër, mund të ulet edhe më tej. Nga ana tjetër, stimulet të gjeneruar në sferën monetare, i bashkohet edhe stimuli fiskal. Krahas uljes së taksave, të cilën administrata amerikane e materializoi në ligj në verën e këtij viti, së fundi Senati Amerikan ka miratuar edhe paketën fiskale, e cila do të shërbejë për përballimin e dëmeve që kanë shkaktuar sulmet terroriste të 11 Shtatorit. Të gjitha këto masa, pritet të japin efektin e dëshiruar në rigjallërimin e ekonomisë, pas gjashtëmuajorit të parë të vitit 2002. Rigjallërimi i ekonomisë amerikane, do të tërhiqte pas vetes edhe ekonominë e Zonës së Euros, e cila aktualisht shfaq shenja të theksuara ngadalësimi. Për t'i paraprirë kalimit në recesion ekonomik, Banka Qendrore Europiane (BQE) ka ulur normën e interesit afatshkurtër të tregut (*repo-rate*) në 3.25 për qind. Në kushtet e vazhdimit të ngadalësimit ekonomik, si edhe të rënies së normës së inflacionit nën nivelin tavan prej 2 për qind të përcaktuar nga BQE, priten ulje të mëtejshme të normës së interesit. Nga pikëpamja e investimit të rezervës valutore, rigjallërimi ekonomik nënkupton rritje të normës së interesit dhe njëkohësisht rritje të të ardhurave të riinvestimit të rezervës valutore.

Në të njëjtën kohë, edhe sipas parashikimeve të bëra në buxhetin e shtetit, gjatë vitit të ardhshëm mendohet të konkludohet në drejtim të privatizimit, ndërmjet të tjerash, edhe të Bankës së Kursimeve dhe të kompanisë Albtelekom. Të ardhurat në valutë që priten të merren nga privatizimi i këtyre ndërmarrjeve të mëdha, do të rrisin vlerën e rezervës ndërkombëtare që investohet dhe në këtë mënyrë, do të shoqërohen edhe me rritje të të ardhurave nga investimi, krahasuar me vitin 2001.

### **3.2. Kursi i këmbimit.**

Gjatë këtij viti, ecuria e kursit të këmbimit të lekut, ndaj valutave kryesore që tregtohen në tregun e brendshëm, ka reflektuar qëndrueshmërinë e ekonomisë në përgjithësi dhe stabilitetin makrofinanciar.

Për pjesën e parë të vitit, ecuria e lekut ka qenë plotësuese në pjesën më të madhe të kohës kundrejt njësisve monetare kombëtare europiane si marka gjermane, lireta italiane, dhrahmia greke etj., (të cilat me fillimin e vitit të ardhshëm do të hiqen nga qarkullimi për t'i lënë vendin euros edhe në formë fizike) si edhe kundrejt dollarit amerikan të vitit. Kjo do të thotë që mbiçmimi i tij ndaj njëres valute, është shoqëruar me nënçmimin e tij ndaj valutës tjetër. Masa e këtyre lëvizjeve, e shprehur në mënyrë relative, ka qenë pothuaj e njëjtë, duke shfaqur reagimin e njëjtë të tregut të brendshëm me zhvillimet në tregun ndërkombëtar valutor.





Diferencat që mund të kenë ekzistuar në momentin e lëvizjes kanë reflektuar preferencën (kërkesën) e tregut për një valutë të caktuar.

Që nga mesi i muajit shtator e në vazhdim, ecuria e kursit të këmbimit të lekut ka reflektuar mbiçmim të tij në raport me të gjitha valutat që tregtohen në tregun e brendshëm. Mendojmë se kjo ecuri mbështetet nga faktorë të tillë si :

- diferenca reale pozitive që ekziston midis investimeve në instrumentet financiare në lekë dhe atyre në valutë. Me afrimin e fundit të vitit, kjo diferencë është rritur si rezultat i ritmit më të shpejtë të rënies së interesave në tregun financiar ndërkombëtar, krahasuar me nivelin stabël në tregun e brendshëm;
- elemente, të cilat janë shndërruar në faktorë me ndikim sezonal në ecurinë e kursit të këmbimit të lekut, që veçanërisht në gjysmën e dytë të vitit, përgjithësisht favorizojnë një mbiçmim të lekut. Si të tillë, mund të përmendim hyrjet në valutë nga emigracioni;
- procesi i prezantimit të euros fizike, i cili, ashtu siç edhe pritej më parë, ka ndikuar në shtimin e ofertës së valutave të Zonës së Euros (si marka gjermane, lireta italiane apo dhrahmia greke) të cilat do të humbin të drejtën ligjore për të shërbyer si mjet pagese, pas muajit shkurt të vitit të ardhshëm.

Krahasuar me fillimin e vitit, në momentin e përpilimit të këtij raporti, leku paraqitet i mbiçmuar si kundrejt dollarit amerikan me 4.4 për qind (në fillim të vitit 143 ndërsa tani 137) ashtu edhe kundrejt markës gjermane dhe përbërësve të tjerë të euros. Më konkretisht, marka gjermane është vlerësuar me 7.7 për qind (në fillim të vitit 67.2 ndërsa tani 62.4).

Ndonëse kursi i këmbimit të lekut është i lirë, Banka e Shqipërisë nuk ka hezitur të ndërhyjë në rastet kur nënçmimi apo mbiçmimi i lekut, i shkaktuar nga faktorë të cilët konsiderohen me ndikim të padëshirueshëm psikologjik dhe të përkohshëm në stabilitetin e tregut të brendshëm të këmbimit dhe të kursit të këmbimit, në psikologjinë e publikut apo në objektivat monetare të Bankës së Shqipërisë.

Në gjysmën e parë të vitit, pjesëmarrja e Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore, ka qenë e limituar në rastet e thithjes së ofertës së tepërt të valutës së krijuar si rezultat i procesit të privatizimit të qeverisë. Në kahun tjetër, në raste të veçanta, Banka e

Shqipërisë ka financuar kërkesën për valutë të Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare (KESH), kur bankat tregtare që e kanë klient këtë kompani nuk kanë qenë në gjendje të sigurojnë shumën e nevojshme në tregun valutor ndërbankar. Së fundi, institucioni ynë ka ndërhyrë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore, për të thithur ofertën e shtuar të valutës, e cila lidhet me procesin e prezantimit të euros fizike.

Lidhur me këtë të fundit, Banka e Shqipërisë ka organizuar punën për kalimin e këtij procesi në mënyrë të pandjeshme në tregun e brendshëm financiar. Një grup i veçantë pune i ngritur në institucion, ndjek përgatitjet e bankave tregtare për këtë proces si edhe ka ndërmarrë iniciativa konkrete për përcaktimin e pozicionit të Bankës së Shqipërisë. Në përgjithësi, përpjekjet tona kanë synuar sqarimin e çështjeve të ndryshme me bankat tregtare, dhënien e informacionit për publikun nëpërmjet mediave si edhe përgatitjen e Bankës së Shqipërisë për të shmangur zhvillime të padëshirueshme në tregun e brendshëm të këmbimit gjatë këtij procesi.

Edhe në vazhdim, Banka e Shqipërisë me politikat e saj do të orientojë tregun drejt zhvillimeve të qëndrueshme, në përputhje me zhvillimet ekonomike brenda vendit dhe ato të tregjeve financiare ndërkombëtare.

### **3.3. Tregu ndërbankar i parasë.**

Gjatë këtij viti, Banka e Shqipërisë konsolidoi përdorimin e instrumenteve indirekte në zbatimin e politikës së saj monetare. U pasurua dhe u përmirësua kuadri rregullativ dhe u fitua përvoja e nevojshme në zbatimin praktik të tyre. Këto instrumente i lejojnë Bankës së Shqipërisë të ndikojë në kushtet e likuiditetit të tregut ndërbankar dhe të kostos së parasë, duke synuar arritjen e objektivave të saj monetarë.

Ndër këto instrumente përmendim: ankandin e operacioneve të riblerjes dhe të operacioneve të anasjellta të riblerjes, depozitën njëditore, kredinë njëditore, operacionet e blerjeve dhe shitjeve përfundimtare të letrave me vlerë të borxhit të qeverisë etj..

Duke njohur vështirësitë që ndesh procesi i transmisionit të vendimeve të politikës monetare në sjelljen e treguesve monetarë dhe të operatorëve të tregut ndërbankar, si rezultat i likuiditetit “të bollshëm” që gjendet në treg, zbatimi i instrumenteve ka synuar thithjen e këtij likuiditeti nëpërmjet operacioneve me natyrë periodike.



Veçojmë përdorimin e ankandit të marrëveshjeve të riblerjes, nëpërmjet të cilit Banka e Shqipërisë ka tërhequr likuiditet nga tregu në mënyrë të vazhdueshme, për periudha kohe afatshkurtra. Synimi është që ky instrument të shndërrohet në mjetin kryesor të politikës monetare që do të përcjellë në tregun ndërbankar qëndrimin e Bankës së Shqipërisë mbi koston e parasë. Rezultatet e deritanishme kanë qenë të mira ndonëse nevojitet përmirësimi i funksionimit të këtij mekanizmi në rastin e shtrëngimit të politikës monetare.

Gjatë vitit, elemente të funksionimit të këtij instrumenti si lloji i ankandit, norma e interesit, afati i maturimit etj., kanë ndryshuar, në funksion të sinjalit që është synuar t'i jepet tregut ndërbankar, për statusin e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë. Përmendim këtu rritjen e normës së interesit me 0.5 për qind, në nivelin aktual prej 7.0 për qind, kur në vjeshtën e hershme të këtij viti, zhvillimet në normën e inflacionit rrezikonin objektivin tonë për këtë tregues në vitin 2001.

Ankandet e para të realizuara me fillimin e këtij viti, ishin të llojit "me shumë çmime dhe me shumë të deklaruar". Norma maksimale e interesit, e përcaktuar dhe e pranuar nga Banka e Shqipërisë, ishte 6.5 për qind. Kjo formë e ankandit, mendojmë se ishte efektive për këto arsye:

- krijoi hapësirën e nevojshme që bankat e nivelit të dytë të gjykonin vetë mbi koston e parasë në tregun ndërbankar, duke nxitur në të njëjtën kohë konkurrencën;
- provoi që norma e interesit e përcaktuar nga Banka e Shqipërisë, ishte realiste për kushtet e tregut ndërbankar.

Në vijim forma e ankandit ndryshoi në "me çmim të përcaktuar, pa shumë të deklaruar". Praktikisht, në këtë formë të ankandit, të gjitha bankat e nivelit të dytë i angazhonin fondet e tyre pranë Bankës së Shqipërisë dhe përfitonin një interes prej 6.5 për qind. Mendojmë se kjo formë ankandi, është më rezultative në rastet kur:

- kërkon të sinjalizohet tregu, për kalimin drejt një stadi "neutral" të politikës monetare;
- siguron një tërheqje likuiditeti më të madhe nga tregu, duke nxitur bankat të operojnë me njëra-tjetrën në tregun ndërbankar.

Përsa i takon vëllimit të fondeve të angazhuara në ankandet e *repo*-ve, ato kanë ardhur në rritje gjatë gjashtëmujorit të parë dhe në zbritje gjatë periudhës së dytë të vitit, lëvizje e kushtëzuar nga kërkesat për likuiditet të Ministrisë së Financave.

Operacionet e kryera në drejtim të tërheqjes së likuiditetit nga tregu, synojnë njëherazi edhe rritjen e ndërveprimit të pjesëmarrësve të këtij tregu. Vërejmë me kënaqësi që operacionet e huadhënieve të bankave midis tyre janë rritur si në numër ashtu edhe në vlerë. Deri në fund të muajit nëntor, totali i vëllimit të transaksioneve të kryera në tregun ndërbankar, ishte 26.8 miliardë lekë nga vetëm 4.6 miliardë gjatë gjithë vitit 2000.

Banka e Shqipërisë ka vijuar organizimin e ankandeve të bonove të thesarit të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë. Pjesëmarrja ka vijuar të jetë kryesisht nga bankat tregtare dhe institucionet financiare jobanka. Banka e Shqipërisë e ka përqendruar vëmendjen edhe në nxitjen e pjesëmarrjes së publikut në tregun primar të bonove të thesarit të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë. Për këtë qëllim, në ambjentet e Bankës së Shqipërisë është hapur një sportel ku mundësohet pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e individëve në ankandet e letrave me vlerë. Aktualisht, puna është përqendruar në kryerjen e një reklamimi më të mirë të kësaj lehtësie, të krijuar edhe për zgjerimin e saj në të gjitha filialet e Bankës së Shqipërisë në qarqe.

#### **4. ZHVILLIMET NË SISTEMIN BANKAR**

Në përgjithësi, gjendja në sistemin bankar, e vlerësuar nga ekzaminimet në vend, paraqitet e mirë, gjë e cila është një element shumë i rëndësishëm për mbështetjen e ekonomisë në zhvillimet e saj. Disa nga karakteristikat kryesore që u vunë re në sistemin bankar gjatë vitit 2001 janë:

- 1) Një rritje e ndjeshme e aktiveve të disa bankave, gjë që tregon për një afrim më të madh të klientëve me to apo dhe për një politikë më agresive nga ana e bankave. Kjo rritje ka ardhur si rezultat dhe i zgjerimit të bankave me degë apo me agjenci të reja.
- 2) Në bazë të një kërkesë nga ana e Bankës së Shqipërisë, të gjitha bankat kanë plotësuar kapitalin minimal të paguar në shumën 700 milionë lekë, gjë e cila është një garanci më e madhe për një sistem të shëndoshë bankar, aq më shumë në kushtet e një zgjerimi të tyre. Përgjithësisht, të gjithë aksionerët kanë qenë të gatshëm për plotësimin e kapitalit në çdo rast nevojë dhe disa banka janë mbi limitin e kërkuar të kapitalit.
- 3) Një ndryshim në strukturën e aktiveve të bilancit të disa bankave, duke u rritur zëri: "kredi për klientët", gjë që tregon që bankat po fillojnë të dalin nga gjendja vrojtuese e pasive, duke luajtur një rol



më të madh. Nga ana tjetër, ky zgjerim i aktivitetit kreditues, në përgjithësi, është shoqëruar me një gjendje të portofolit të kredisë të përkeqësuar. Kjo ka ardhur nga disa shkaqe, më kryesoret do t'i përmblihdhnim:

- a) fillimi i aktivitetit kreditues pa siguruar më parë një staf të përgatitur, për t'ju përgjigjur kërkesave të këtij sektori;
  - b) mosmbështetja në procedura dhe politika të plota e të sakta, gjë e cila do të ishte një mbështetje e domosdoshme për stafin e kreditit.
- 4) Ka patur një gjendje likuiditeti të mirë, përgjithësisht si rezultat i investimit në zëra likuidë si vendosje në bankat e tjera apo bono thesari, gjë e cila nuk i ka rrezikuar bankat nga mungesa e likuiditetit. Kanë patur nën kontroll risqet e normave të interesit apo të kursit të këmbimit, duke tentuar në mbajtjen e niveleve të GAP-it sa më të ulëta apo të niveleve të *spread*-it optimale, duke përmirësuar ndjeshëm, në krahasim me një vit më parë, administrimin e aktiv-pasiveve të bankës. Ka një progres në këtë fushë, duke futur metoda bashkëkohore për përgatitjen e një informacioni sa më të plotë dhe të shpejtë.
- 5) Përgjithësisht, të gjitha bankat kanë dalë me rezultat pozitiv (përveç dy bankave) me një fitim në rritje në krahasim me një vit më parë, kjo si rezultat i zgjerimit të tyre, i mbulimit të shpenzimeve të hapjes dhe përmirësimit të strukturës së aktiveve të bilancit në vendosje në zëra më fitimprurës. Tendenca e të ardhurave paraqitet e qëndrueshme.

#### 4.1. Ekzaminimet e bankave tregtare.

Gjatë vitit 2001, mbikëqyrja bankare ka mbuluar plotësisht me ekzaminime të plota të gjitha bankat e sistemit. Kanë përfunduar 11 ekzaminime të plota dhe janë në proces për t'u përfunduar edhe dy banka të tjera. Përgjithësisht, të gjitha bankat e ekzaminuara janë vlerësuar sipas sistemit CAMELS 2 "Kënaqshëm", gjë që është mjaft pozitive, vetëm një bankë është vlerësuar 3 "Mesatar" dhe një 4 "I dobët".

Nga ekzaminimet e kryera kanë dalë këto probleme kryesore:

- 1) Përkeqësim i portofolit të kredisë, që është një tregues i rrezikshëm. Ky përkeqësim ka ardhur kryesisht nga;
  - a) një sistem politikash dhe procedurash të varfra dhe të parinovuara me produktet e reja të futura;
  - b) dobësitë e konstatuara në ndjekjen e kredive. Kontaktimet me klientët mbasi lëvrohej kredia ishin të rralla ose mungonin fare.

- Për takimet e kryera nuk lihej gjurmë në dosjet e kreditit. Nuk kërkohet informacion financiar (bilancet) për të njohur gjendjen e klientit mbasi lëvrohet kredia;
- c) dobësitë në plotësimin e dosjeve me dokumentacionin e nevojshëm, që është mbështetje për mbledhjen e kredive të lëvruara;
  - d) përqëndrime të kredive në fusha të veçanta për kredinë konsumatore;
  - e) klasifikim i kredive jo sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë, gjë që në shumë raste ndryshon rezultatin financiar, duke ulur të ardhurat.
- 2) Përqendrim i investimeve në një përfitues të vetëm. Kjo sidomos për vendosjet në bankat e tjera, që për disa banka arrinte mbi 50 për qind të aktiveve.
  - 3) Moszbatim me korrektësi i manualit të kontabilitetit bankar, si për llogaritë e bllokuara për garanci, garancitë e marra në formë pronësie, mosregjistrim të kufirit të lëvruar e të papërdorur për kreditë me kufi në zëra jashtë bilancit etj..
  - 4) Moszbatim i ligjeve dhe rregulloreve të Bankës së Shqipërisë. Kjo për disa çështje si:
    - a) pozicionin e hapur valutor. Disa banka meqenëse kapitalin e paguar e kanë në dollarë, mbajnë në dollarë edhe rezultatin financiar, duke e futur në pozicion. Në këtë mënyrë, pozicioni i hapur valutor në dollarë mbyllet, duke shkelur rregulloren;
    - b) mosplotësimin e dosjeve të kreditit me dokumentacionin e kërkuar sipas kërkesave të ligjit: "Për bankat në Republikën e Shqipërisë";
    - c) klasifikim të kredive jo sipas kërkesave të rregullores përkatëse;
    - d) tejkalim të përqendrimit në një depozitues të vetëm mbi limitin e lejuar në rregulloren përkatëse;
    - e) mosparaqitjen e informacionit të kërkuar për administratorët e bankave në Bankën e Shqipërisë, për marrjen e miratimit të saj. Në këtë mënyrë, kanë funksionuar disa administratorë të lartë, edhe më shumë se një vit, të pamiratur. Kjo pengon zbatimin e kërkesave të Bankës së Shqipërisë, për administratorë të kualifikuar në drejtim të tyre;
    - f) mbledhjet e komitetit të kontrollit ishin të rralla dhe jo sa ç'kërkohet në ligjin e cituar më lart.



5) Mosfunksionimi i mirë i kontrollit të brendshëm, si dhe në disa raste moskoordinim i punës me komitetin e kontrollit. Në disa banka u konstatua se komiteti i kontrollit kryen një punë formale.

## 5. Bursa e Tiranës

Aktiviteti operacional i Departamentit të Bursës së Tiranës ka qenë inekzistent. Viti 2001 është krejtësisht i ngjashëm me vitin e kaluar ku në sesionet e Bursës së Tiranës nuk është ekzekutuar asnjë transaksion në letrat me vlerë.

- **Bonot e thesarit**  
**Shkaku kryesor për këtë mungesë transaksionesh në bonot e thesarit është mosekzistenca e asnjë oferte për shitje apo dhe për blerje të bonove të thesarit nga ana e bankave të nivelit të dytë apo e shoqërive private të licencuara për tregtimin e tyre në bursë.**
- **Aksionet**  
Në Bursën e Tiranës ende nuk është listuar ndonjë shoqëri aksionere. Kjo ka ardhur kryesisht si rezultat i:

**1. mospërbushjes së kriterëve cilësorë të kuotimit në bursë, të tilla si: aftësi të spikatura në administrim dhe prodhim raportesh financiare, cilësorë e transparente;**

2. mosinteresimit të shoqërive aksionere private për të listuar aksionet e tyre në listën zyrtare të Bursës së Tiranës dhe rrjedhimisht, i mosdëshirës së tyre për t'u kthyer në shoqëri aksionere publike e për të ngritur kapital nëpërmjet bursës;

3. mosofrimi nga shteti i ndonjë shoqërie aksionere për privatizim nëpërmjet ofertës publike.

### 5.1. Shkëputja e Bursës së Tiranës.

Lidhur me procesin e shkëputjes së Bursës së Tiranës nga Banka e Shqipërisë dhe themelimin e saj si institucion i pavarur, kjo e fundit po vepron konform të gjitha detyrimeve ligjore për mbajtjen e Bursës së Tiranës si njësi organizative e saj, deri në momentin e transformimit të saj në shoqëri anonime.

Pavarësisht nga sa më lart, gjatë këtij viti janë shënuar dhe hapa pozitivë, si:

1. Miratimi i projektligjit "Mbi disa ndryshime në ligjin nr.8080, datë 01.03.1996, "Për letrat me vlerë"", të propozuar nga Komisioni i Letrave me Vlerë. Ky ligj, tashmë ka ngarkuar juridikisht Ministrinë e Financave dhe atë të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për realizimin e shkëputjes përfundimtare të Bursës së Tiranës nga Banka e Shqipërisë. Këto dy ministri duhet të shpejtojnë punën e tyre për të realizuar shkëputjen e Bursës së Tiranës nga Banka e Shqipërisë në zbatim të ligjit përkatës, pasi prej rreth 9 muajsh nga hyrja në fuqi e tij nuk është bërë pothuajse asgjë.
2. Përgatitja e një studimi të fizibilitetit nga ana e Bursës së Tiranës, në të cilin paraqiten opsionet e mundshme të themelimit institucional të saj, fushat e mundshme të aktivitetit në të cilat ajo mund të angazhohet dhe kërkesat për kapitalin e nevojshëm për funksionimin normal të saj si treg instrumentesh të ndryshme financiare.

**Megjithatë, nëse ka angazhim serioz të të gjitha autoriteteve përkatëse, nisur nga rritja e nevojave të bankave dhe bizneseve për të gjetur mundësi të reja investimi dhe sigurimi kapitalesh, viti 2002 pritet të sjellë njëfarë zhvillimi në tregun e kapitaleve.**

## **6. BUXHETI I BANKËS SË SHQIPËRISË**

### **6.1. Realizimi i pritshëm i buxhetit të Bankës së Shqipërisë për vitin 2001.**

Për vitin 2001 u parashikua që të realizoheshin të ardhura në masën 11.4 miliardë lekë, të kryheshin shpenzime në masën 2.26 miliardë lekë dhe për pasojë fitimi i planifikuar rezultoi 9.14 miliardë lekë, prej të cilit 9.1 miliardë lekë ose 99.56 për qind do të derdhej në buxhetin e shtetit.

Bazuar në ecurinë e deritanishme **të ardhurat gjithsej**, parashikohet të realizohen në masën 96.75 për qind ose rreth 370 milionë lekë më pak se sa plani, si pasojë e reduktimit të të ardhurave nga investimi i rezervës valutore si dhe i portofolit të bonove të thesarit, të emetuara nga Ministria e Financave.





Reduktimi i të ardhurave nga investimi i rezervës valutore **erdhi si pasojë e rënies së ndjeshme të normave të interesit në tregjet ndërkombëtare, rënie e cila pritet të vazhdojë. Kështu, normat e planifikuara për tremujorin e tretë dhe të katërt të vitit ishin në nivelet 5.39 dhe 5.34 për qind. Këto norma u rishikuan në përputhje me ecurinë e tregjeve ndërkombëtare në nivelet përkatësisht 3.39 dhe 3.32 për qind. Megjithatë, Banka e Shqipërisë punoi në kohë për zbutjen e këtij faktori duke ndryshuar strukturën e investimit të instrumenteve financiare në favor të letrave me vlerë në valutë të huaj me norma më të larta interesi.**

**Reduktimi i të ardhurave nga portofoli i bonove të thesarit** erdhi si pasojë e reduktimit të shumës së portofolit dhe të ndryshimit të *yield*-it të bonove të thesarit.

Në planifikimin e bërë në fillim të vitit, portofoli (përfshirë ristrukturimin e borxhit) është vlerësuar në masën 80.45 miliardë lekë, ndërsa në rishikim është vlerësuar 70.22 miliardë lekë.

*Yield*-i mesatar vjetor i bonove në planifikim është marrë rreth 7.72 dhe 10.62 për qind përkatësisht për bonot e thesarit tre dhe gjashtëmujore. Në rishikim normat e interesit janë vlerësuar sipas përkatësisë në 7.85 dhe 9.48 për qind.

**Shpenzimet gjithsej** parashikohet të realizohen në masën 100 për qind.

*“Interesa paguar për huatë”* rezultojnë me kursim prej 36.7 milionë lekësh në elementin “Hua greke për bilancin e pagesave”. Ky zë pas pagimit të këstit të dytë të vitit, si rezultat i hyrjes së Greqisë në EMU, ka patur ndryshime në rënie të bazës së kontratës së huasë dhe të normës së interesit që zbatohet.

*“Interesat për marrëveshjet e riblerjes (repo) dhe depozitë njëditore”* rezulton me një tejkallim prej 206 milionë lekësh. Ndikimi në rritjen e shpenzimeve për operacionet me repo vjen si rezultat i vlerës më të madhe të angazhuar mesatarisht në ankandet repo në krahasim me parashikimin, si dhe të rritjes së normës së interesit të ankandit në krahasim me parashikimin. Këtu përfshihen dhe interesat e paguar bankave tregtare për depozitat me afat njëditor, instrument i ri i politikës monetare.

*“Interesa për remunerimin e rezervës së detyrueshme”, të cilat përfaqësojnë interesat, që u paguhen bankave tregtare për depozitat në lekë dhe në valutë, rezultojnë me kursim prej 86 milionë lekësh. Edhe pse niveli i depozitave gjithsej është rritur, rënia e përqindjes së interesave ka efekt më të madh.*

Zërat e tjerë të buxhetit të Bankës së Shqipërisë rezultojnë me kurtime, të cilat nuk janë të ndjeshme në shpenzimet gjithsej të buxhetit.

## **6.2. Objektivat kryesorë të buxhetit për vitin 2002.**

Të ardhurat gjithsej janë planifikuar në masën 9 miliardë e 209 milionë lekë; 2 miliardë e 193 milionë lekë më pak se plani i vitit 2001 ose 1 miliard e 823.6 milionë lekë më pak se realizimi i pritshëm i këtij viti.

***Artikulli “Të ardhura nga interesat e qeverisë” përfaqëson 67.5 përqind të të ardhurave nga interesat. Ky artikull planifikohet në masën 6 miliardë e 212.4 milionë lekë dhe përfaqëson të ardhurat nga bonot e thesarit.***

Artikulli “Të ardhura nga bankat dhe institucionet e huaja” me vleftë 2 miliardë e 981 milionë është pakësuar në vlerë absolute 1 miliard e 203 milionë lekë në krahasim me realizimin e pritshëm.

Planifikimi është bërë duke patur parasysh nivelin e rezervës valutore prej 700 milionë dollarësh (të konvertuar) sipas një portofoli, në të cilin të ardhurat nga investimet në bono dhe notat e thesarit të shtetit amerikan dhe agjencive zënë afërsisht, 46 përqind të investimit, në euro zënë 39 përqind, gbp zënë 3 përqind dhe sdr 12 përqind. Përqindja mesatare e interesit të ponderuar të investimit të rezervës valutore është planifikuar 2.56 përqind.

Për vitin 2001, parashikohet një buxhet shpenzimesh në një vleftë prej rreth 2 miliardë e 926.5 milionë lekësh ose 642 milionë më shumë se realizimi i pritshëm i këtij viti.

Kapitulli “Shpenzime për interesa” është planifikuar në një vleftë prej 1 miliard e 699.3 milionë lekësh, me një rritje prej rreth 153 milionë lekësh, e cila vjen kryesisht sepse rriten shpenzimet e interesave për rezervën e detyrueshme, që mbajnë bankat e nivelit të dytë në Bankën e Shqipërisë.



Kapitulli “Shpenzime operative” parashikohet me një rritje prej 162 milionë lekësh në krahasim me planin e vitit 2001, duke synuar kryerjen e shpenzimeve më shumë për rritjen e transparencës, për kualifikimin e punonjësve, për sigurimin e vazhdimësisë së biznesit, për zhvillimin e infrastrukturës së nevojshme dhe për informatizimin e veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë.

Kapitulli “Shpenzime amortizimi” ka një rritje të theksuar në krahasim me realizimin e pritshëm të vitit 2001, për arsye të planifikimit të shpenzimeve të amortizimit të kartëmonedhës, e cila furnizohet në vitin 2002.

### **6.3. Investimet e planifikuara.**

Për vitin 2002, planifikohen të kryhen investime në Bankën e Shqipërisë me fondet e veta në një vlerë prej 200 milionë lekësh më shumë se plani i vitit 2001.

Në vitin 2002 planifikohen të përfundojnë projekte të rëndësishme si: sigurimi i rezervës së nevojshme fizike të kartëmonedhës, automatizimi i përpunimit të monedhës, rritja e niveleve të sigurisë dhe mbrojtjes të ambienteve të brendshme të Bankës së Shqipërisë, informatizimi i pagesave të kleringut, rikonstruksioni i godinës së Bankës së Shqipërisë dhe ndërtimi i ambienteve të shërbimit për personelin.

Me fondet e Bankës Botërore në një vlerë prej rreth 270 milionë lekësh do të realizohet në afat përfundimi i projekteve të rëndësishme informatike të administrimit të rezervës valutore dhe operacioneve të tregut monetar, informatizimi i kontabilitetit dhe i pagesave ndërbankare.

## **7. HYRJA NË QARKULLIM E EUROS FIZIKE**

Në 1 janar të vitit 2001, në 12 shtete të Europës Perëndimore do të fillojë përdorimi i euros fizike, monedha e përbashkët europiane. Kjo monedhë do të zëvendësojë monedhat e këtyre shteteve dhe, pas marsit 2002, do të jetë e vetmja monedhë që do të qarkullojë me kurs ligjor. Ky proces zëvendësimi është e qartë se ka ndikime edhe në vende të tjera jashtë zonës së euros, përfshi Shqipërinë. Për pasojë, është i domosdoshëm organizimi i një pune përgatitore me synim realizimin e dy qëllimeve kryesore:

- pranimin e natyrshëm e pa probleme në mjedisin ekonomik shqiptar të monedhës së re dhe përdorimin e saj për konvertim

dhe mjet pagese;

- zbutjen sa më shumë të jetë e mundur, të përhapjes së panikut dhe të spekulimeve në këtë proces.

**Puna përgatitore është e përqëndruar në organizimin e fushatës informative për publikun shqiptar, me qëllim që ai të njihet me tërësinë e kartëmonedhave dhe të monedhave të reja metalike që shumë shpejt do t'i ketë në duar si dhe në krijimin e një sasive rezerve euro fizike, me qëllim plotësimin e kërkesave të publikut për këtë monedhë.**

Fushata informative, e nisur që në muajin qershor të vitit 2001, ka ardhur duke u intensivuar. Kjo fushatë ka patur si qëllim të bëjë të njohur publikisht që euro zëvendëson 12 monedha të tjera, periudhën e zëvendësimit, institucionet që duhen përdorur për të kryer këmbimin. Kjo fushatë është organizuar në formën e seminareve me gazetarët dhe bankat tregtare, nëpërmjet botimit të artikujve dhe materialeve të tjera informuese në botimet e Bankës së Shqipërisë dhe në shtypin e përditshëm si dhe nëpërmjet bërjes së njoftimeve zyrtare, po në shtypin e përditshëm, dhe qarkullimit të fletëpalosjeve, posterave dhe të broshurave shpjeguese për euron. Paralelisht me fushatën informative është organizuar dhe fushata trajnuese me specialistë të bankave tregtare dhe të zyrave të këmbimit valutor me qëllim që ata të jenë në gjendje të njohin parandë e re, elementet e sigurisë në prerje të ndryshme të saj. Në të njëjtën kohë me Bankën e Shqipërisë, fushatë informative kanë zhvilluar dhe bankat tregtare.

Përsa i takon sigurimit të sasisë së nevojshme të euros fizike në vend, për të përballuar kërkesat për këmbimin fizik të saj, secila bankë tregtare, me mjetet e veta, ka planifikuar sasi të që janë gjykuar të përshtatshme dhe janë marrë masat për furnizimin me to. Furnizimi me euro do të kryhet pranë secilës bankë tregtare brenda muajit dhjetor 2001 dhe euro do të jetë në dispozicion të publikut qysh në ditët e para të janarit 2002. Sasia fillestare e furnizimit është në shumë të tillë që mjafton për 7-10 ditë pune. Nga ana tjetër, për të mundësuar zëvendësimin fizik pa probleme, Banka e Shqipërisë, gjithashtu, do të krijojë rezervat e veta.

Për vitin 2002, në tërësi programi ekonomik parashikohet të jetë në të njëjtin kuadër si edhe viti 2001. Në këtë mënyrë është programuar rritje ekonomike në masën 7 për qind në terma realë duke siguruar inflacion të ulët në nivelin 2-4 për qind.

